

VENDIM
Nr.562, datë 3.8.2011

PËR CAKTIMIN E NIVELIT BAZË TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 54 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Niveli bazë i së ardhurës nga papunësia të jetë 6 850 (gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në grupin 25, titull 10550, kap.1, art.606 “Transferta të buxhetit familjar dhe invalidët” (E ardhura nga papunësia).

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr.697, datë 18.8.2010 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha